



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 8 prill 2014, në mbledhjen e II-të (dytë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Islam Revuçi, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullhau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agim Kikaj, nënkyetar i Komunës, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, propozoi të përfshihen edhe:

- ❖ **Themelimi i Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane të qytetit, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e komunës së Podujevës**
- ❖ **Çështja e lokacionit për ndërtimin e obeliskut të heroit Afrim Zhitia**

z. Kadri Avdiu, theksoi, pasi që e kam marrë thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje dhe mbledhjen e Kuvendit e kam vërejtur se në rend dite nuk është paraparë edhe çështja e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, çështje për të cilën në mënyrë unanime jemi marrë vesh që në afatin sa më të shkurtër do të përgatitet materiali dhe do të shqyrtohet në Kuvend. Kjo marrëveshje është arritur në shkurt të këtij viti dhe në atë rast është thënë, nëse është nevoja për çështjen e cekur do të thirret edhe mbledhje e jashtëzakonshme, mirëpo ka kaluar muaji mars e tash jemi në prill dhe ende nuk është përgatitur materiali i nevojshëm.

Mënyra e këtillë e veprimit më bënë që unë në cilësinë e shefit të Grupit të këshilltarëve të PDK – së të mos mbaj më takime konsultative me kryesuesin e Kuvendit, ngase shpesh po thuhet se Ekzekutivi nuk po i përgatit materialet e nevojshme, mirëpo në rastet e këtilla kryesuesi i Kuvendit duhet të kërkoj që Ekzekutivi të përgatit materialet e nevojshme.

Sa i përket Komisionit për propozimin e emërtimeve të rrugëve, në mandatin e kaluar është ngritur një komision i tillë, mirëpo sa ne jemi të informuar ai komision nuk ka punuar fare, por pavarësisht nga kjo nuk ka problem që ky komision të themelohet edhe në këtë mandat dhe përfundoi, unë pajtohem që dy çështjet e propozuara të përfshihen në rend dite.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i mendimit se ky Komitet duhet t'i rekomandoj Kuvendit që çështja e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes së konvokuar për 10 prill 2014.

Kjo çështje ka mundur të vendoset edhe në mandatin e kaluar kur kryesuesi i Kuvendit ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, ngase në vitin 2012 nga Banka Botërore janë ndarë 100.000 € për një obelisk e ai ka qenë i Heroit Afrim Zhitia e për këtë qëllim është caktuar lokacioni afér 5 ari por kjo çështje nuk është realizuar.

Me donacionin i cili tash është ndarë është paraparë edhe shtimi i hapësirës dhe është e domosdoshme të debatohet në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet sa më parë.

Sa i përket gjendjes në terren jam i mendimit se është jo morale që përgjegjësit e institucioneve të Komunës, për pronën komunale, të bëjnë kompromise me qytetarë ngase sipas kësaj mënyre edhe unë mund të rrethoj një sipërfaqe të caktuar dhe t'i detyroj përgjegjësit e institucioneve të vijnë dhe të bëjnë kompromise me mua.

Sa i përket peticionit, është e njëjta listë të cilën na e ka prezantuar Kryetari i komunës në mbledhjen e kaluar të Kuvendit e cila i ka vetëm emrat dhe mbiemrat, pa numra personal, por e kemi edhe listën tjeter që janë pro ndërtimit të obeliskut e cila është më valide ngase përveç emrave dhe mbiemrave janë edhe numrat personal.

Për çështjen e obeliskut ne kemi obligim moral dhe lidhur me këtë ne kemi pasur mirëkuptim dhe jemi pajtuar që gjatë mbledhjes përkatëse të Kuvendit të jepet një pauzë në mënyrë që shefat e Grupeve të këshilltarëve të përafrojnë qëndrimet, pauzë në të cilën është arritur marrëveshja, e ne qëndrojmë pas saj që kjo çështje të mos politizohet, mirëpo duhet thënë edhe atë se, nëse Kuvendi nuk e vendos këtë çështje atëherë mbeten format tjera ligjore për shqyrtimin e çështjes së uzurpimeve dhe njerëzve që qëndrojnë pas tyre.

z. Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë se është bërë një pauzë gjatë mbledhjes përkatëse të Kuvendit dhe është mbajtur një takim me shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe unë qëndroj pas marrëveshjes së arrituri. Përndryshe pajtohem që dy pikat e propozuara të përfshihen në rend dite.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në mënyrë të qartë vërehet se jemi për atë që dy çështjet e propozuara të përfshihen në rend dite, pra ne i mbështesim mirëpo konsideroj se tanë nuk duhet të debatojmë ngase këtë mund ta bëjmë kur këto dy çështje të përfshihen në rend dite, por fillimisht duhet të deklarohemi se a pajtohemi që këto çështje të përfshihen në rend dite apo jo.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar u miratua njëzëri së bashku me dy pikat e propozuara.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur më 12 mars 2014 në mbledhjen e këtij Komiteti

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti finansiar për vitin 2013

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, sipas raportit vërehet se ka tejkalime, ka ndërhyrje në disa mese dhe ka rrugë në të cilat është punuar si dhe rrethoje të shkollave që nuk janë përfshirë në raport ndërsa punimet janë kryer andaj raporti bie ndesh me atë çfarë është miratuar vitin e kaluar e kjo do të thotë se pa miratim të Kuvendit ka shumë ndërhyrje në investime kapitale. Unë nuk jam kundër që janë bërë ato punime por nuk pajtohem me atë që punimet nuk janë përshkruar në raport.

Raporti finansiar paraprak dhe ky raport për shumë çka nuk përputhen.

Po i përmendi disa punime që janë kryer e nuk figurojnë askund e ato janë: rrethojat në shkollat e fshatrave Lladoc, Tërrnavë e Katunishtë, pra punimet e cekura a janë bërë në mënyrë private nga donatorë apo me mjete të Komunës dhe cilado mënyrë qoftë ajo duhet të përshkruhet në raport. Pastaj janë dy rrugë, jo në fshatin tim por në trevën time, të cilat janë asfaltuar gjatë periudhës së fushatës, punime të cilat nuk kanë qenë të miratuara në Kuvend por ato punime janë kryer dhe pas kodit përkatës thuhet, rruga Tërrnavë – Halabak që në realitet nuk është por janë rrugë të lagjeve e që nuk kanë të bëjnë me rrugën e cekur.

Rruga tjetër është rruga që lidhë lagjet Sejdiu – Maloku – Avdiu e cila është kryer në vitin 2012 ndërsa në vitin 2013 kemi shuma të paguara siç janë 31.000 € dhe 22.000 , kjo përmua nuk është e qartë.

Unë shtroj pyetjen a është shkelje ligjore të investohet në projekte të ndryshme pa miratim në Kuvend dhe të mos respektohet Kuvendi, kjo shtron pyetjen tjetër, përsë i miratojmë raportet, dhe përsë e miratojmë buxhetin dhe përsë çështjet përcillen për shqyrtim në Kuvend kur dihet se Ekzekutivi dhe drejtorët e Drejtive duhet të respektojnë atë që miratohet në Kuvend dhe jo të punojnë jashtë përgjegjësive në raport me Kuvendin.

z. Kumrie Hoti, theksoi, pas një analize të Raportit finansiar për vitin 2013 më duhet të potencojo se sipas mendimit tim në komunën tonë ka pasur shumë shkelje në përcaktimin dhe implementimin përkatësisht realizimin e projekteve të shumta gjatë vitit 2013.

Kur e them këtë i kam parasysh Kornizën afatmesme buxhetore të Komunës së Podujevës 2014-2014 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2014-2016.

Në këtë kontekst dhe gjithnjë duke i krahasuar projektet prioritare në këto dy korniza dhe duke e analizuar raportin finansiar për vitin 2013 më duhet të them se ka pasur një ndarje jo reale ndaj qytetarëve të disa pjesëve të Komunës sonë, siç është fshati Revuç i cili ka rrëth 105 familje me gjithsej 1200 banorë prej të cilëve

më shumë se gjysma nuk i kanë rrugët kryesore të asfaltuara e nëse e marrim në përqindje rrugët në Revuç janë të asfaltuara diku rrith 30%.

Rrugë të asfaltuara janë rrith 4.100 m. dhe po e përsëris që janë vetëm rrugët kryesore ku një pjesë e caktuar e tyre as që ka banorë.

E posedoj edhe foton të cilën mund ta shihni ku rrugët e asfaltuara janë të paraqitura me ngjyrë të gjelbër derisa ato të pa asfaltuara janë me ngjyrë të kuqe, prej këtyre me të gjelbër në njërin krah kemi rrith 670 m. rrugë që kalon nëpër fusha dhe që i lidhë vetëm 8 familje dhe tjetra i ka 525 m. njëjtë nëpër fusha dhe që i lidh 13 familje, të dyja këto lidhin vetëm rrith 110 banorë.

Të pa asfaltuara janë rrith 4.300 m. rrugë kryesore gjithnjë duke mos i përfshirë rrugët lidhëse apo rrugicat e fshatit.

Pastaj kemi rastin e Dobratinit ku rrugët janë 95% të asfaltuara përfshirë edhe rrugicat, vijon Metehia, Dobërdoli, Bradashi, Bajçina bile edhe fshati Kërpimeh por gjendjen sikurse Revuç i ka edhe fshati Pakashticë si ajo Poshtme ashtu edhe ajo e Epërme.

Duke u bazuar në dokumentet e përmendura më lartë e them se anëtarët e Kuvendit nuk ju kanë përbajtur betimit të dhënë dhe kjo nuk është në rregull, ngase Kapitulli II, nen 2 pika 2.2 i Statutit të Komunës së Podujevës thotë:

“Organet e Komunës kujdesen që qytetarët t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim t'i gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta në shërbimet komunale”

Pyetja ime është si ka pasur mundësi që rruga kryesore e fshatit Revuç përkatësisht vazhdimi i rrugës e cila në Kornizën afatmesme buxhetore 2012-2014 ishte projekt prioritari për vitin 2012 dhe atë nga granti prej 95.000 € dhe nuk ka ndodhur kurrë, ku është dallimi i këtyre qytetarëve nga të tjerët.

Projekti i njëjtë si projekt prioritari për investim prej 50.000 € nga granti ishte prioritet edhe në vitin 2013 dhe nuk është realizuar fare.

Projekti i njëjtë me një planifikim për investim prej 90.000 € nga granti është prioritet edhe për vitin 2014, të shohim.

Gjithmonë po flasim për 150.000 € investim në një rrugë e cila u bënë zgjidhje 600 banorëve e që nuk është bërë kurrë por të shohim se a do të jemi ne ata që do të angazhohemi që edhe këtyre qytetarëve t'ua ofrojmë të drejtën e tyre elementare e në të njëjtën kohë ne ta kryejmë obligimin tonë kushtetues e ligjor.

Në raportin financier 2013 pasqyra e pagesave të kryera për operatorët ekonomik që kaanë kryer punime, paraqet se vetëm gjatë vitit 2013 mes shumë projekteve të tjera në Komunën tonë vetëm në fshatin Bradash janë paguar projekte në vlerë prej 217.490 €. Në fshatin Sfeçël janë asfaltuar rrugë sekondare 152.282 €.

Në Revuç janë investuar 15.000 € për një rrugë në gjatësi 400 m që lidhë 8 familje, punimet në këtë rrugë janë bërë në kohën e zgjedhjeve.

Tash shtrohet pyetja se sa km. rrugë i ka fshati Bradash që duhet investuar 217.000 € për asfaltim kur dihet se është pothuajse fshati i parë në Komunën tonë në të cilën është asfaltuar rruga dhe si ka mundësi të jenë paguar 152.000 € për rrugë sekondare derisa Revuç i ka disa fshatra përreth nuk e kanë të asfaltuar as rrugën kryesore.

Kjo është shkelje dhe diskriminim i skajshëm dhe thjesht nëse qytetarët nuk janë të diskriminuar në bazat e përmendura në Statut të komunës, atëherë po ekzistojka një bazë tjetër që nuk është potencuar aty sepse diskriminimi është prezent. Andaj Ju lus të na tregoni me çka dallojnë qytetarët e atij fshati nga të tjerët që të mos i gjëzojnë të drejtat ose të na tregoni pse të tjerët janë të privilegjuar edhe me rrugë sekondare.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LVV-së, në mbledhjen e vet të rregullt këtë Raport finansiar e ka diskutuar dhe analizuar së bashku me grupin e ekspertëve dhe ajo që fillimisht vërehet është ngritja e shpenzimeve siç janë: telefonia mobile që është 16.774, pastaj shpenzimet për furnizime për zyrë, 114.000 € pa specifikuar çfarë shpenzimesh, furnizim ushqim dhe pije 18.063,36 €, naftë për ngrohje qendrore 65.853,64 € (nga 54.632,86 €), gjithashtu për qymyr ka ngritje nga 35.151,33 € në 65.853,64 €, karburante për vetura 95.000 € që jam i mendimit se është shumë mjaftë e lartë, rritje 100% ka për sigurimin e automjeteve ku në vitin 2012 kanë qenë 7.545,00 € ndërsa në vitin 2013 janë 14.533,08 €, qiraja për ndërtesa është 1.327,71 € e cila nuk specifikohet dhe jam i interesuar të di se çfarë shpenzimesh janë këto, botimet e publikimeve janë 13.930,91 € dhe shumë të tjera.

Pajisje mjekësore janë 45.000 €, ndërsa pajisjet tjera janë 44.000 € e nuk specifikohet se për çfarë pajisjesh bëhet fjalë.

Në këtë mbledhje i pranishëm është edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, andaj dua të shfrytëzoj rastin dhe ta pyes, në këtë raport nuk kam vërejtur se ka shpenzime për mirëmbajtjen e shkollave e që unë konsideroj se do duhej gjithsesi të investohet në këtë drejtim.

z. Naim Çunaku, theksoi, është bërë praktikë që Raporti finansiar dërgohet për shqyrtim pa reportin e Auditorit të brendshëm edhe pse në vazhdimësi është kërkuar që këto dy raporte të shqyrtohen njëkohësisht.

Gjithashtu në vazhdimësi është kërkuar edhe plani i punës i Zyrës së prokurimit, mirëpo edhe ky plan kurrë nuk është dërguar për shqyrtim, e sikur ta kishim këtë material do t'i kishim parë fazat e shpenzimit të buxhetit të Komunës.

Defekt tjetër që e ka përcjellë shpenzimin e parasë publike në Komunën tonë, sipas mendimit tim, është mosparaqitura e raporteve financiare, edhe pse vitin e kaluar është paraqitur raporti tremujor por nuk është paraqitur raporti gjashtëmuajor dhe ai nëntëmuajor, derisa Ligji për menaxhimin e financave publike e përcakton se duhet të përgatiten dhe shqyrtohen raportet e cekura.

Vërejta se në raport ishte një pjesë e konsiderueshme e buxhetit që është shpenzuar për paga të punëtorëve në bazë të kontratës mbi vepër, ajë shumë është dhjeta mijëra euro, e sipas mendimit tim ky është defekt që nuk është dashur të ndodhë ngase është numër i madh i punëtorëve të cilët kanë përfituar nga kontrata mbi vepër në kohëzgjatje 12 muaj derisa jemi në dijeni se sa është maksimumi i kontratës mbi vepër.

Përndryshe, neve na është paraqitur raporti i përgjysmuar, jam në dijeni se për profesionist është i kuptueshëm, mirëpo konsideroj se ky raport do duhej të jetë i kuptueshëm jo vetëm për këshilltarët e Kuvendit por edhe për të gjithë qytetarët.

Si mund të thuhet se është i kuptueshëm kur për rrugë lokale, po të mblidhen shifrat japin shumën mbi tre milion euro, pastaj si mund të orientohet dhe sa kohë i nevojitet një laiku për të parë se ku janë shpenzuar ato para.

Është shumë e qëndrueshme vërejtja e z. Kadri Avdiut, se ne në Kuvend kemi vendosur për projektet prioritare për realizim në vitin 2013 e këto janë paraqitur në mënyrë shumë të përgjithësuar dhe ka dal se shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar e shumë projekte të cilat nuk janë paraparë fare janë realizuar, e kjo sipas mendimit tim e humb kuptimin që Kuvendi të merret me projekte prioritare derisa ato mund të anashkalohen në këtë formë, përndryshe mënyra e veprimit të këtillë është shkelje ligjore.

Gjithashtu më ra në sy që një operator ekonomik i cili e ka specialitet ose fushëveprimin e tij krejt diçka tjetër dhe ne paguajmë për krejt diçka tjetër, rasti ka të bëjë kur në një autoservis bëhet furnizimi me naftë dhe atë në autoservisin DPZ "Color", kodi 615131874, - ku thuhet, karburante për vetura, derivate për gjenerator. Shembull tjetër i cili më bëri përshtypje është që Komuna e Jonë një pjesë të madhe të mjeteve e ka shpenzuar për bartjen e nxënësve, më vjen mirë që është bërë kjo, mirëpo kur ndalesh tek operatorët ekonomik del se njëri ka tregti të lëvizshme ndërsa prej Komunës së Podujevës, për bartjen e nxënësve, ka marrë 29.000 €, pra kjo nuk është e natyrshme.

Kam vërejtur edhe atë se kemi pagesa për OJQ që ne jemi në dijeni se nuk ekzistojnë përkatësisht nuk funksionojnë e pagesa janë bërë edhe në këto raste siç janë rastet e GVL-së dhe Shoqatës së gazetarëve.

z. Isuf Latifi, theksoi, z. Kumrie Hoti, më tepër ka folur për planifikim buxhetor se për Raportin financiar, andaj unë nuk kam përgjigje lidhur me diskutimin e saj ngase ajo foli për Kornizën afatmesme buxhetore që është pjesë e planifikimit të buxhetit.

Sa i përket çështjes së rrethojave të shkollave këtë e ka bërë kompania "Olti" dhe janë pagesat e përshkruara.

Anëtari i këtij Komiteti nga radhët e LVV-së bëri pyetje lidhur me qiranë, kjo ka të bëjë me pagesën e qirasë për një shtëpi ku është vendosur Handikos-i.

Rrugët lokale dhe kanalizimet lidhur me këtë kodet ekonomike janë në planin kontabël të cilin e përcakton Ministria e Financave dhe shumat në këto kode janë të specifikuara në bazë të kontratave dhe punëve të kryera, pra të gjitha shpenzimet që bëhen për kanalizime përmblidhen në kodin e kanalizimeve ashtu siç përmblidhen shpenzimet e rrugëve lokale në kodin e rrugëve lokale.

Përndryshe të jeni të bindur se ky raport është shumë më i detajizuar se sa mënyra të cilën e parashohin dispozitat ligjore, këtë e them duke u bazuar në atë se është shumë e mundimshme të shkruhen 312 pagesa të investimeve kapitale, sipas situacioneve që kanë ndodhur e këtë e kemi bërë ngase nuk kemi pasur asgjë të fshehim ngase sikur të kishim pasur për të fshehur diçka këtë pjesë nuk do ta paraqitnim.

z. Kumrie Hoti, theksoi, në diskutimin tim asgjë nuk kam folur jashtë asaj që ka të bëjë me projektet prioritare, pra gjithherë duke u referuar në Kornizën afatmesme buxhetore e cila është e miratuar në Kuvend.

z. Naim Çunaku, theksoi, në diskutimin tim paraprak unë e thashë atë se sa është transparent ky raport përkatësisht sa mund ta kuptoj qytetari i thjeshtë, këtë nuk e thash për vete ngase unë kam përvojë mjaftë të madhe në Kuvend dhe nuk kam të paqartë asgjë.

Për diskutimin e z. Kumrie Hotit, përgjigja e drejtorit z. Isuf Latifi, ishte se diskutimi i të përmendorës nuk ishte në kuadër të temës për të cilën po debatojmë, përgjigjja

e atillë më duket paksa tendencioze, këtë e them duke u bazuar në atë se në fillim të mbledhjes drejtori i cekur e bëri një përshëndetje të veçantë për ata që janë për herë të parë në përbërjen e Kuvendit përkatësisht të këtij Komiteti dhe se zonja në fjalë foli më tepër sikur sot të bëheshin priorititet për vitin e ardhëm dhe vuri theksin përse disa mijedise janë anashkaluar.

Jam në dijeni se nuk jam në kontekstin e temës por konsideroj se duhet ta them se së paku katër herë kam qenë te z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për një rrugë prej fshatit Penuhë deri në fshatin Buricë, në gjatësi afro 500 m. rrugë nëpër të cilën kalojnë afro 100 nxënës e cila është në gjendje shumë të keqe ngase edhe me traktor nuk mund të qarkullohet dhe nëse merret si rast, kur intervenohet dhe kërkohet së paku katër herë dhe nuk shtrohet me zhavorr ajo rrugë, kjo nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë tjetër përvèç se është e këtij apo atij, përndryshe arsyeshmëri tjetër nuk ka meqë atyre nxënësve ju ka vështirësuar shkuarja në shkollë dhe vajtja në shtëpi.

z. **Nexhami Rudari**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, gjatë diskutimeve u përmenden rrethojat e shkollave dhe shtoi, kjo ka ndodhë në pjesën e dytë të vitit përkatës ngase ne kishim planifikuar ndërtimin e një shkolle në fshatin Siboc për të cilën ishin paraparë 350.000 €, mirëpo fatmirësisht ajo shkollë është ndërtuar me një çmim shumë më të ulët dhe pjesa e mbetur e mjeteve ka kaluar në të njëtin kod, investime kapitale, përkatësisht në kodin e renovimit dhe rregullimit të hapësirave shkollore.

Gjithashtu z. Haki Rudari, e përmendi çështjen e mirëmbajtjes së shkollave, lidhur me këtë mund të them se shkollat mirëmbahen në vijimësi dhe atë nga kodi i investimeve kapitale dhe kodi për mallra dhe shërbime prej ku janë kryer punimet e ndërtimit të rrethojave të shkollave, ndërsa këtë vit parashihet të kryhen rrethojat edhe të 5 apo 6 shkollave, gjithashtu është bërë dezinfektimi, drzinsekimi dhe derratizimi i të gjitha shkollave, përvèç tri objekteve të cilat kanë qenë në renovim komplet. z. Naim Çunaku, shtoi çështjen e operatorëve ekonomik të cilët bëjnë transportin e nxënësve, për këtë mund t'ju them se asnjë operator ekonomik nuk mund të lidhë kontratë nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore, andaj si e ka emrin firma përkatëse unë nuk jam në dijeni por jam i bindur se ajo firmë duhet ta ketë në rregull tërë dokumentacionin që i plotëson kushtet për transport të udhëtarëve.

z. **Rafet Llapashtica**, theksoi, nga kureshtja i kam vizituar dy shkolla dhe atë shkollat në Batllavë dhe Zhitë, i posedoj edhe fotot, por jam i bindur se edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit është në dijeni për gjendjen shumë të rëndë të atyre objekteve të cilat edhe paraqesin rrezikshmëri për nxënës, andaj konsideroj se në shkollat e cekura do duhej gjithsesi të investohet në riparimin e tyre.

Sa i përket rrethojave të shkollave, ne i gjëzohemi iniciativës për ndërtimin e tyre, mirëpo unë e kam vizituar shkollën në Lladoc dhe e kam parë se pjesa e prapme e rrethojes është punuar me armaturë e cila përdoret për ndërtim të vrazhda, nuk jam në dijeni se kjo a ka qenë në projekt apo jo.

Mund të them se gjendja në arsim nuk është e mirë e këtë e ilustron edhe rasti kur largohet profesori me përgatitje master dhe në vend të tij pranohet i ashtuquajturi profesor i cili nuk e ka të përfunduar fakultetin e kjo është shumë banale dhe nuk e ndritë cilësinë e arsimit, ky rast ka ndodhë në kohën e fushatës zgjedhore, mirëpo ky nuk është rast i vetëm.

z. Nexhami Rudari, theksoi, ne nuk mund të flasim në mënyrë hipotetike, është bërë kështu e do duhej të bëhej ashtu dhe shtoi, jam plotësisht në dijeni për gjendjen e të gjitha objekteve shkollore ngase përvëç tjerash ne si administratë komunale por edhe Inspeksioni i MASHT-it i bëjmë vizitat e rregullta në të gjitha shkollat.

Sa i përket rrethojave të shkollave, operatori ekonomik punët i kryen në bazë të projektit dhe paramasës e paralogarisë, në rastet që i përmendi parafolësi, për shkak të pamundësive buxhetore nuk kemi mundur t'i kryejmë rrethojat e të gjitha shkollave, por edhe ato që i kemi kryer nuk i kemi bërë komplet sipas standardeve ngase pjesët ballore që përkufizohen me rrugë i kemi bërë me gilindera ndërsa pjesët e pasme të shkollave që kufizohen me ara punimet janë bërë me shufra të metalta të vendosura në beton e kjo vetëm për t'i penguar kafshët që të mos hyjnë në oborre të shkollave.

Sa i përket dy objekteve shkollore të cilat i përmendi z. Rafet Llapashtica, e respektoj veprimin e tij dhe këtë e konsideroj si ndihmë ngase nëse ju në cilësinë e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dilni në terren dhe i shihni objektet shkollore dhe bëni presion tek ne, me këtë na shtohet edhe neve mundësia që të bëjmë presion në MASHT.

Gjithashtu, po e them sërisht se u tha në mënyrë hipotetike ngase nuk u tha me emër, që Drejtoria e Arsimit ka larguar profesor universitar dhe ka pranuar njerëz pa kualifikim përkatës, kisha dëshiruar të di se cili është ky rast.

z. Rafet Llapashtica, parafolësit iu përgjigj, po e keni larguar z. Bashkim Statovci, magjistër, dhe në vend të tij e keni pranuar një person i cili nuk e ka të kryer as bachelorin dhe atë në kohën e fushatës zgjedhore, e them këtë edhe pse personalisht nuk i njoh asnjërin prej tyre.

z. Nexhami Rudari, theksoi, së pari ne nuk e kemi larguar askënd nga puna dhe së dyti nuk po flas për ndonjë rast konkret por në përgjithësi, nuk mjafton të thuhet vetëm magjistër ngase shtrohet pyetja, a është i fushës përkatëse që kërkohet sipas konkursit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në vitin 2013 kam qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe lirshëm mund të them se të gjitha projektet në kompetencë të asaj Drejtorie janë realizuar në harmoni me rregullat dhe dispozitat ligjore dhe se realizimi i projekteve absolutisht nuk është bërë mbi bazën e ndikimeve partiake.

Pas votimit u konstatua se raporti finansiar, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim me shumicë votash përkatësisht me 5 vota për, 4 vota kundër dhe 1 votë të përbajtur.

Pauzë 14.45' – 15.00'

Fillimi i konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarje.

4. Propozimi i Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të komunës së Podujevës nga viti 2013 në vitin 2014 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore

- z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.
- z. Kumrie Hoti**, shtroi pyetjen si ka mundësi të mbeten mjete të pashfrytëzuara derisa nuk janë realizuar projekte me prioritet konkretisht rrugë me gjatësi të shkurtër me kosto më të vogël se shuma e cila bartet nga viti i kaluar në vitin 1014.
- z. Isuf Latifi**, theksoi, të hyrat vetanake të arkëtuara në nëntor dhe dhjetor, në veçanti në dhjetor, përpunohen në janar të vitit vijues në rastin konkret në janar 2014, andaj nuk ka mundësi të shfrytëzohen më parë e kjo është rregull për të gjitha komunat, përndryshe kjo është e paraparëve dispozita ligjore.
- z. Kumrie Hoti**, theksoi, rruga e fshatit Revuç që e përmenda në diskutimet e mëhershme ka qenë në prioritete edhe në vitin 2012 edhe në vitin 2013. Por edhe pse ka pasur mjetet buxhetore ai projekt nuk është realizuar.
- z. Kadri Avdiu**, theksoi, e kam parë gjendjen e rrugës të cilën e përmendi kolegia ime z. Kumrie Hoti, ka të drejtë plotësisht dhe konsideroj se nuk është në rregull që një pjesë e një lagjeje shumë të madhe të mbetet rruga në atë gjendje. Ekuipazhimi se mjetet vetanake të grumbulluara në dy muajt e fundit të vitit nuk mund të shfrytëzohen në vitin përkatës, mirëpo në vitin vijues kur ato mjetet destinohen duhet të destinohen në projekte prioritare e jo siç dëshiron Ekzekutivi.
- z. Mehmet Gashi**, kryesues, theksoi, rregullimi i rrugës në Revuç është në prioritete të vitit 2014 dhe jam shumë i interesuar që ai projekt të përfundoj. Mjetet për destinim sipas propozimit të këtij vendimi janë propozuar ngase për projekte përkatëse kanë qenë të parapara mjetet nga të hyrat vetanake e që nuk kemi pasur mundësi t'i paguajmë vitin e kaluar andaj është bërë propozimi konkret.
- z. Isuf Latifi**, theksoi, dëshiroj të sqaroj se unë nuk jam kompetent për realizimin e projekteve të ndryshme por jam menaxhues i mjeteve buxhetore, e di mjaft mirë gjendjen e rrugës të cilën e përmendi z. Kumrie Hoti, mirëpo ju bëjë me dije se projekte prioritare në vitin 2014 nuk mund të realizohen nëse nuk bëhet projekti zbatues, pra tash e tutje projektet nuk mund të realizohen vetëm me paramasë dhe paralogari siç është vepruar deri më tanë, andaj duhet njoftuar mijediset në të cilat janë paraparë projekte prioritare të përgatitin projektet zbatuese në mënyrë që të krijojen kushtet për publikimin e tenderit.
- z. Fidan Rekaliu**, theksoi, duhet të jemi të kënaqur me projektet e realizuara në Komunën tonë, në veçanti në asfaltimin rrugëve. Pajtohem se duhet të asfaltohet edhe rruga në fshatin Revuç, që u përmend gjatë këtij debati, mirëpo për këtë çështje nuk duhet të humbim shumë kohë ngase drejtori z. Isuf Latifi i dha sqarimet shumë të qarta.
- z. Kumrie Hoti**, theksoi, e potencova rrugën në fshatin Revuç, ku edhe jetoj, mirëpo unë e kam shumë afër rrugën e asfaltuar andaj këtë çështje nuk e shtrova për interes timin por për interes të banorëve të pjesës së epërme të fshatit Revuç.
- z. Rafet Llapashtica**, theksoi, lidhur me mjetet e infrastrukturës në shumë 122.000 € konsideroj se fillimi duhet të sqarohet në mënyrë të saktë se projektet për të cilat propozohet të destinohen këto mjete a kanë qenë në prioritete që janë miratuar në Kuvend, nëse jo atëherë në asnjë mënyrë ky propozim nuk duhet të miratohet. Gjithashtu për mua është konfuze ngase po thuhet se këto mjete janë propozuar për destinim për rrugët e përfunduara, andaj për këtë duhet të jepen sqarime.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, për projektet përkatëse kanë qenë të parapara edhe mjetet vetanake që në vitin 2103 nuk janë arkëtuar 100% andaj pjesa e mbetur duhet të paguhet në këtë vit, gjithashtu për njërin projekt nuk kanë mjaftuar mjetet e parapara dhe ato duhet të plotësohen.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim me shumicë votash përkatësisht 6 vota për, asnjë kundër dhe 4 vota të përbajtura.

5. Propozimi i Vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Fexhi Sylës – Gllamnik, Smajl Isufit – Majac, Fadil Zhitit – Lluga, Abit Bunjakut – Sallabajë, Adem Kamerollit – Llapashticë e Poshtme, Faik Zhitia – Lluga)

z. Mehmet Gashi, kryesues, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në materialin që na është dorëzuar nuk i kemi fletët poseduese dhe kopjet e planit për ngastrat përkatëse, andaj nuk jam në dijeni se si mund të votojmë apo të miratojmë diçka që nuk e kemi të qartë. Pra konsideroj se për të gjithë parashtruesit e kërkesave, propozimit të vendimit është dashur t'i bashkëngjitet edhe kopja e planit, e kjo gjithsesi duhet të përgatitet për Kuvend.

z. Naim Çunaku, theksoi, edhe më parë në rastet e ngjashme si kjo për të cilën po debatojmë nuk janë dorëzuar kopjet e planit, mirëpo në rastin konkret konsideroj se për mbledhje të Kuvendit duhet të përgatiten dëshmitë përkatëse për secilin rast.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në asnjë mënyrë nuk jam që të pengohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, mirëpo në mesin e parashtruesve të kërkesave janë edhe Fadil Zhitiu dhe Faik Zhitiu nga fshati Llugë, sigurisht ato prona janë të tyre, së paku këtë drejtori i Drejtorisë kompetente është dashur që paraprakisht të vërtetoj këtë, mirëpo jam i mendimit se për dy kërkesat e cekura nuk do duhej të vendosim derisa të vendoset çështja e lokacionit të obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, pra droja ime është nëse ne marrim vendim për ndërrim të destinimit të atyre pronave ndoshta po e përshkallëzojmë problemin në terren për rastin e përmendur.problemin në terren për rastin e përmendur.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet të shqyrtohen veç e veç propozimet e vendimeve me obligim që për mbledhje të Kuvendit të sigurohen kopjet e planit të ngastrave përkatëse të parashtruesve të kërkesave.

6 . Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc

z. Mehmet Gashi, kryesues, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet ngritja e këtij Komisioni në përbërje:

1. Avni Ajeti, LDK
2. Kadri Avdiu, PDK,
3. Haki Rudari, LVV
4. Ruzhdi Dema, Shërbimi civil i Komunës
5. Përfaqësuesi i Organizatave të dala nga Lufta e UÇK – së

Në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

7. Çështja e lokacionit për ndërtimin e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, me qëllim të tejkalimit të gjendjes së krijuar lidhur me ndërtimin e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, do të ishte mirë të ngritet një komision në përbërje të përfaqësuesve të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, komision i cili do të bëjë vlerësimin e gjithanshëm dhe do t'i rekomandoj Kuvendit mënyrën konkrete të zgjidhjes të kësaj çështjeje.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se funksioni i legjislativit nuk është që të merret me punë ekzekutive, pra Ekzekutivi duhet të përgatit propozimin e vendimit përkatës dhe ta dërgoj për shqyrtim në Kuvend.

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e ka elaboratin kadastral dhe e vërteton se prona përkatëse është publike dhe duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për lirimin e asaj prone.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, po e përsëris detyra e këtij komisioni do të jetë që në mënyrë të gjithanshme të vlerësoj situatën e krijuar në terren dhe për zgjidhjen e çështjes t'i bëjë rekomandim konkret Kuvendit.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, në rastin konkret janë ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe është konstatuar se në rastin për të cilin po bëhet fjalë ka uzurpime, përndryshe uzurpime ka në gjithë Kosovën, mirëpo shqetësimi im më i madh është se gjendja në atë mjedis është tejet e tensionuar, andaj nuk ka asnjë të keqe të shkojmë dhe të bisedojmë me ata njerëz në mënyrë që t'i përafrojmë qëndrimet e tyre që aktualisht janë diametralisht të kundërtë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk pajtohem me mendimin e drejtorit ngase konsideroj se ai mund t'i merr tre apo katër zyrtarë dhe një nga Ministria përkatëse dhe të shkojnë e të bisedojnë me ata njerëz, ngase ne si këshilltarë të Kuvendit nuk mund t'i qasemi një problemi që nuk është në kuadër të kompetencave tonë.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, po e vërej se z. Rafet Llapashtica, nuk është i interesuar të merr pjesë në punën komisionit që u propozua, mirëpo mund të përfshihet kushdo që ka vullnet të mirë, me dëshirë as unë nuk do të isha pjesë e këtij komisioni por me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje, nëse pajtohen këshilltarët në Kuvend, do të jem në përbërje të komisionit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ose unë nuk po kuptoj ose ne të gjithë nuk po kuptohemi ngase drejtori z. Abaz Llugaliu, tha se ekziston mundësia e konfliktit në mes banorëve të atij mjedisit, unë nuk di në mes kujt mund të ketë konflikt ku atje ka raste që disa persona e kanë uzurpuar pronën e Komunës, pra ata a kanë konflikt me Institucionet e komunës apo me kënd, këtë unë nuk e kuptoj, nuk e kuptoj se çfarë ka familja Zhitia me personat të cilët e kanë uzurpuar pronën e Komunës.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë për zgjerimin e sipërfaqes, në pronë të Komunës, për ngritjen e lapidarit për Dëshmorin Afrim Zhitia, projekt për të cilin janë siguruar mjetet financiare. Andaj nuk e kuptoj përsë mund të ndodh ndonjë konflikt nëse Institucionet e Komunës ekzekutojnë vendimet që prona e uzurpuar të kthehet në pronësi të Komunës.

Pajtohem me drejtorin z. Abaz Llugaliu, se usurpime ka, përveç rastit konkret, ka në gjithë territorin e Komunës tonë, lidhur me këtë kolegu z. Naim Çunaku, ka kërkuar disa herë që të shqyrtohet çështja e usurpimeve. Në fshatin Bellopojë është rasti i usurpimit të pronës e me këtë është bllokuar rruga Bellopojë – Tërrnavë dhe sipërfaqja e uzurpuar, këtë vit, është mbjell me grurë, rast për të cilin edhe Ekzekutivi edhe Legjislativi heshtin.

z. **Fidan Rekaliu**, theksoi, qëllimi i jonë është të gjejmë një rrugëdalje të përbashkët e mbi të gjitha që dy palët e involvuarë në këtë rast të mos kenë konflikte për një çështje të ndjeshme që ndërlidhet me Dëshmorin Afrim Zhitia, që unë jam shumë i vogël të flas për veprën e tij e cila ka qenë madhore, andaj jam i mendimit se duhet të bisedojmë me të dy palët.

Jemi në dijeni se rasti ka të bëjë me pronë të Komunës, por pavarësisht nga kjo konsideroj se nuk është mirë të marrim ndonjë vendim i cili do të jetë shkas për ndonjë konflikt apo deri te më e keqja.

z. **Mehmet Gashi**, kryesues, theksoi, për të gjithë ne është mjaftë e qartë se çfarë roli ka Ekzekutivi dhe çfarë Kuvendi, mirëpo unë nuk shoh kurrrarë problemi që të ngritet një komision i cili do të vlerësoj gjendjen në terren në mënyrë që të kemi një pasqyrë të gjendjes reale, pra të bëjmë një bisedë me njerëzit e involvuar në këtë çështje por punët tjera do t'i kryej Ekzekutivi.

z. **Kadri Avdiu**, theksoi, nuk pajtohem me kryesuesin që një komision i Kuvendit të del në vendin e ngjarjes dhe të bisedoj me njerëzit e atjeshëm ngase gjendja reale konstatohet shumë lehtë nga Ekzekutivi dhe prona e uzurpuar mund të kthehet në gjendjen e mëparshme. Mirëpo derisa Institucioni i Komunës hesht a të rikthehet prona e uzurpuar apo jo, është normale që uzurpuesit thojnë ajo tokë është e jona ngase e ka shfrytëzuar babë e babagjysh.

Koj çështje është duke u anashkaluar, këtë e them ngase që nga mbledhja e Kuvendit kur kemi marrë pauzë, në zyrën e Kryetarit të Komunës, jemi marrë vesh që në mbledhjen e parë të radhës të Kuvendit do të kryhet kjo punë, por kaluan dy muaj e kjo çështje nuk u zgjidh.

z. **Haki Rudari**, theksoi, i dëgjova diskutimet dhe pajtohem se në parim ne të gjithë jemi për zgjidhjen e këtij problemi dhe nga gjithë ajo që u tha vërehet neglizhenca e Drejtorisë kompetente, por pavarësisht nga kjo ky problem duhet të zgjidhet ngase nëse tërhiqemi nga ky rast, raste të tilla mund të na paraqiten edhe në fshatra tjerë.

Nëse në rastin për të cilin po debatohet ka usurpim të pronës së Komunës, Drejtoria kompetente është dashur që personave përkatës t'ua dërgoj vërejtjen dhe të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për kthimin e asaj prone.

z. **Abaz Llugaliu**, theksoi, Ekzekutivi i Komunës i ka zhvilluar procedurat, janë nxjerr vendime për konstatim të usurpimeve, mirëpo ekzekutimi i vendimeve nuk është bërë ngase është fazë e ankesës e afati është 30 ditë.

z. **Mehmet Gashi**, kryesues, theksoi, për t'u shqyrtuar ndonjë çështje në mbledhje të Kuvendit është e nevojshme që paraprakisht Ekzekutivi të përgatit materialin e nevojshëm.

z. **Naim Çunaku**, theksoi, kryesuesi po e shpjegon formën se si organizohet mbledhja e Kuvendit, mirëpo në mbledhjen e Kuvendit plotësisht në pajtim me procedurat dhe dispozitat ligjore, me rastin e miratimit të rendit të ditës, mund të propozohet që kjo çështje të përfshihet në rend dite dhe kryesuesi një propozim

të atillë domosdo duhet ta vejë në votim dhe nëse mbështetet nga shumica çështja do të vihet në rend dite pavarësisht se a është përgatitur materiali nga Ekzekutivi.

Nuk kisha dashur që lidhur me obeliskun e Dëshmorit Afrim Zhitia, të votohet pro dhe kundër, pra nuk kisha dashur që për këtë çështje këshilltarët e Kuvendit të ndahen pro dhe kundër.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, duhet të jemi realist dhe të kuptojmë gjendjen në terren dhe karshi gjendjes në terren të vijmë te marrja e një vendimi për një personalitet shumë të madh dhe shtoi, propozimi im është që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e KPF – së, dhe të shqyrtohet vetëm kjo pikë e rendit të ditës, kuptohet që për atë mbledhje Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë të përgatit dëshmitë e nevojshme.

Lidhur me propozimin e parafolësit, njëzëri u vendos që më datën 15 prill 2014, në orën 13:00, KPF të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme dhe të shqyrtoj vetëm pikë rendit të ditës, përkatësisht

❖ **Çështja e lokacionit për ndërtimin e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia**

Me obligim që Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të siguroj dokumentacionin dhe dëshmitë relevante.

8. Themeli i Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane të qytetit, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e komunës së Podujevës

z. Agim Kikaj, nënkyretar i Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet ngritja e komisionit në përbërje prej 11 anëtarëve në strukturën:

LDK-5 anëtarë

PDK- 4 anëtarë

LVV- 1 anëtar

AAK- 1 anëtar

Komision në të cilin shumica duhet të jenë ekspert të fushave apo lëmive përkatëse.

Mbledhja përfundoi në orën 15.45'

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01- 006-50504

Podujevë,

8 prill 2014

Kryesuesi i Komitetit

Mehmet Gashi